DEKRET
Nr.2101, datë 21.5.1998

PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.7573, DATË 16.6.1992 "PËR ZGJEDHJET E ORGANEVE TË PUSHTETIT LOKAL", I NDRYSHUAR ME LIGJET NR.7593, DATË 29.7.1992; NR.7798, DATË 23.2.1994; NR.1579, DATË 13.8.1996; NR.8151, DATË 12.9.1996 DHE NR.8346, DATË 13.5.1998

Në mbështetje të.nenit 28 pika 19 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese",

DEKRETOJ:

Neni 1

Në nenin 33 të ligjit nr.7573, datë 16.6.1992 "Për zgjedhjet e organeve të pushtetit lokal", me ndryshimet e mëvonshme, shtohet një paragraf për mënyrën e votimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve me këtë përmbajtje:

"Procedura e votimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve është si më poshtë:

Votimi i parë merret me shumicë dy të treta të votave të anëtarëve të pranishëm. Nëse nuk arrihet kjo shumicë, ndërpritet votimi dhe lihet një kohë e mjaftueshme për reflektim dhe konsulencë me ekspertët e organizmave që ndjekin procesin zgjedhor dhe pas 9 orësh bëhet votimi i dytë. Pas këtij votimi, nëse nuk arrihet kjo shumicë dy të treta të votave të anëtarëve të pranishëm, pas tri orësh kryhet një votim i ri, në të cilin vendimi konsiderohet i marrë, bazuar në shumicën e thjeshtë të votave të anëtarëve të pranishëm."

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
Rexhep Meidani